



Република Македонија
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ
O M B U D S M A N
Republic of Macedonia

**RAPORT I VEÇANTË I
E AVOKATIT TË POPULLIT
PËR PËRFSHIRJEN NË ARSIM FILLOR TË
FËMIJËVE ME NEVOJA TË VEÇANTA**

Tetor, 2006

PËRFSHIRJA E FËMIJËVE ME NEVOJA TË VEÇANTA NË ARSIMIN FILLOR DHE FORMAT E MUNDSHME TË DISKRIMINIMIT TË TYRE

Avokati i Popullit, si organ i autorizuar për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve dhe në kuadër të kësaj edhe të fëmijëve, krahas veprimit sipas parashtresave të parashtruara e ndjek edhe realizimin e mbrojtjes të të drejtave të fëmijëve të Republikës së Maqedonisë.. Gjatë kryerjes së funksionit të tij, Avokati i Popullit vëmendje të veçantë u kushton fëmijëve me nevoja, për të cilët edhe pse shteti ndërmerr mjaft masa, ata edhe më tej gjenden në margjinat e jetës, më së shumti të diskriminuar dhe nuk gëzojnë kushte dhe mundësi të barabarta për realizimin e të drejtave të tyre.

Sipas nenit 23 të Konventës për të drejtat e fëmijës, e cila si dokument i ratifikuar ndërkombëtar, në përputhje me nenin 118 të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë, paraqet pjesë të rendit të brendshëm të Republikës së Maqedonisë, shteti obligohet që fëmijës me pengesa mendore ose fizike, t'i mundësojë ta gëzojë tërësisht dhe me dinjitet jetën, në kushte me të cilat sigurohet dinjiteti, nxitet pavarësia dhe lehtësohet pjesëmarrja aktive e fëmijës në shoqëri. Fëmijës me pengesa në zhvillim, në përputhje me këtë dispozitë të Konventës, shteti duhet t'i sigurojë përkujdesje të veçantë dhe ta nxisë e sigurojë ndihmë, fëmijës i cili i përmbush kushtet për një gjë të tillë, varësisht nga mjetet me të cilat i ka në dispozicion dhe nga gjendja e fëmijës.

Së këtejmi, fëmijës me pengesa në zhvillim, shteti duhet t'i sigurojë qasje efikase për arsimim dhe aftësim.

Në mënyrë që të realizohen këto qëllime, në dispozitat ligjore të Republikës janë përcaktuar kushtet për përfshirjen e fëmijëve me pengesa në zhvillim në procesin arsimor. Kështu, fëmijët me penga në zhvillim, në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e fëmijëve, duhet të përfshihen në kopshtet e fëmijëve, nëpër grupe me numër të caktuar të fëmijëve dhe me ta të punohet mbi bazë të programeve të veçanta.

Pastaj, sipas Ligjit për arsim fillor, me plan programe të veçanta mësimore organizohet dhe realizohet veprimtaria edukative – arsimore, me ç'rast shkolla fillore duhet të mundësojë arsimimin e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore.

Nga kjo që u tha, rezulton se intenca e Republikës së Maqedonisë për t'i përfshirë në arsim, sidomos në arsimin fillor, edhe fëmijët me pengesa psikofizike, me ç'rast të njëjtët mund t'i sistematizojnë nëpër paralele të veçanta ose në shkolla të veçanta. Mirëpo, varësisht nga shkalla e pengesave, këta fëmijë mund të përfshihen edhe në arsimin e rregullt me fëmijët e tjerë.

Por, këto janë vetëm norma dhe dispozita, ndërsa përvoja është diç tjetër, përkatësisht gjatë zbatimit praktik të zgjidhjeve ligjore paraqiten mjaft probleme dhe pengesa, dhe për këtë shkak nuk sigurohet qasje adekuate dhe e barabartë e fëmijëve

me pengesa në zhvillim, prandaj dhe këta fëmijë shpesh herë diskriminohen gjatë realizimit të të drejtave të arsimimit.

Nga veprimi i deritanishëm i institucionit tonë është konstatuar se prindërit e fëmijëve me pengesa në zhvillim akoma ballafaqohen me rezistencë dhe paragjykime tek kuadri arsimor në shkolla dhe prindërit e fëmijëve të tjerë, me ç'rast ndodh që fëmija me pengesa në zhvillim të refuzohet dhe mos pranohet në arsimin fillor ose madje fëmija i tillë të pranohet, dhe pas një periudhe të caktuar kohore të çregjistrohet, me çka prindërit lihen që të gjenden si të dinë vetë me fëmijët. Gjithashtu, gjatë ushtrimit të detyrës me këtë kategori të fëmijëve, probleme kanë edhe mësuesit nga shkaku se jo sa duhet janë të aftësuar për të punuar me këta fëmijë dhe të gjejnë metoda adekuate për përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta

Me qëllim që të fitojmë informata më të plota në lidhje me realizimin e të drejtës për arsimimin e fëmijëve me nevoja të veçanta dhe për rezultatet e përfshirjes së tyre në arsimin fillor, me qëllim të ndërmarrjes eventualisht të masave përkatëse, gjatë vitit 2006 realizuam anketë me numrin më të madh të shkollave fillore.

Të dhëna janë kërkuar nga 226 shkolla fillore prej gjithsej 354 shkolla të Republikës së Maqedonisë	
Janë përgjigjur	159
Nuk janë përgjigjur	67

1. PËRFSHIRJA E FËMIJËVE ME NEVOJA TË VEÇANTA NË SHKOLLA FILLLORE

PËRFSHIRJA E FËMIJËVE ME NEVOJA TË VEÇANTA NË SHKOLLA FILLLORE	
Shkollat, në të cilat ka të përfshirë fëmijë me nevoja të veçanta në arsimimin fillor	140
Shkollat, në të cilat nuk ka të përfshirë fëmijë me nevoja të veçanta	19
Gjithsej	159

Nga informatat e pranuar është konstatuar se në numrin më të madh të shkollave fillore të Republikës së Maqedonisë ka të përfshirë fëmijë me nevoja të veçanta në arsimin e rregullt.

Në numrin më të madh të shkollave fillore janë përfshirë fëmijë me pengesa të lehta psikike apo fizike.

2. PËRFSHIRJA NË ARSIMIN FILLOR-VARËSISHT NGA LLOJI I PENGESËS NË ZHVILLIM

PËRFSHIRJA NË ARSIMIN FILLOR-VARËSISHT NGA LLOJI I PENGESËS NË ZHVILLIM	
Shkollat, në të cilat janë të përfshirë fëmijët me probleme psikofizike	64
Shkollat, në të cilat janë të përfshirë fëmijët me probleme të lehta psikike	62
Shkollat, në të cilat janë të përfshirë vetëm fëmijë me probleme të rënda fizike	5
Shkollat, në të cilat janë të përfshirë vetëm fëmijë me probleme të lehta fizike	4
Shkollat, të cilat nuk kanë ofruar të dhëna precize	3
Shkollat, në të cilat janë të përfshirë vetëm fëmijë me probleme të rënda psikike	2
Gjithsej	140

Sipas të dhënave, në arsimin fillor të rregullt, janë të përfshirë fëmijë me: probleme të motorikës, të folurit, dëgjimit, me pengesa të lehta, me vështirësi për përvetësimin e materialit dhe probleme me vëmendjen dhe përqendrimin, fëmijë hiperaktiv, fëmijë me sëmundje mendore, me sindrom të daunit, epilepsi, paralizë të fëmijëve, me pengesa të lehta mendore, invaliditet fizik ose me pengesa të kombinuara të zhvillimit psikofizik.

Në të shumtën e rasteve, fëmijët me nevoja të veçanta, të përfshirë në arsimin fillor nuk e kryejnë arsimin fillor, por mbeten disa vjet duke u shkolluar.

3. FËMIJËT QË JANË PËRFSHIRË NËPËR SHKOLLA A E KANË KRYER DERI NË FUND ARSIMIN FILLOR NË ATË SHKOLLË?

FËMIJËT QË JANË PËRFSHIRË NËPËR SHKOLLA A E KANË KRYER DERI NË FUND ARSIMIN FILLOR NË ATË SHKOLLË?	
Numri i shkollave, në të cilat fëmijët me nevoja të veçanta tërësisht e kanë përfunduar arsimin fillor	69
Numri i shkollave, në të cilat nuk e kanë kryer arsimin fillor	42
Numri i shkollave, në të cilat arsimimi vijon edhe më tej	18
Numri i shkollave, në të cilat një pjesë e nxënësve e kanë përfunduar arsimin, ndërsa një pjesë janë çregjistruar	11
Gjithsej	140

4. SHKAQET E BRAKTISJES SË SHKOLLËS

SHKAQET E BRAKTISJES SË SHKOLLËS	
Me kërkesë të prindërve të fëmijës	33
Për shkak të përkeqësimit të gjendjes tek fëmija	20
Për shkak të mosekzistimit të kushteve për vazhdimin e mëtejshëm të arsimit	13
Për shkak të shkaqeve të tjera	8
Për shkak të rezistencës nga prindërit e tjerë	5
Me iniciativë të shkollës	4
Për shkak të rezistencës së kuadrit arsimor	4
Nuk i kanë përmendur shkaqet e vërteta	16

Një pjesë e fëmijëve, vazhdojnë me shkollimin në shkolla të tjera speciale, ndërsa pjesa më e madhe nga arsye e të ndryshme e braktisin shkollimin. Si arsye më e shpeshtë për braktisjen, para kohe të arsimit fillor, janë kërkesat e prindërve që fëmija ta ndërpres shkollimin, por është i madh numri i fëmijëve të cilët e kanë braktisur arsimin fillor për shkak të përkeqësimit të gjendjes shëndetësore dhe mospasjes së kushteve për vazhdimin e shkollimit nëpër shkollat fillore ekzistuese. Gjithashtu, një pjesë e fëmijëve e braktisin arsimin fillor të rregullt edhe për shkak të rezistencës së prindërve të fëmijëve të tjerë, rezistencës së arsimtarëve ose mospranimin nga fëmijët e tjerë, përkatësisht për shkak të përkeqësimit të komunikimit ndërmjet fëmijës dhe arsimtarëve ose me fëmijët e tjerë, si dhe për shkak të pamundësisë që ta ndjekin mësimin dhe t'i përvetësojnë përmbajtjet mësimore.

5. A JEP REZULTATE TË MIRA PËRFSHIRJA E FËMIJËVE ME NEVOJA TË VEÇANTA NË ARSIMIN E RREGULLT?

Mbi bazë të përgjigjeve të dhëna është e qartë se vetëm një pjesë e vogël e të anketuarve konsiderojnë se me përfshirjen e fëmijëve në arsimin e rregullt janë arritur rezultate solide, por edhe ata potencojnë se para së gjithash rezultatet kanë të bëjnë me socializmin dhe fitimin e shprehive elementare të fëmijëve, por nga aspekti i përvetësimit të përmbajtjeve mësimore, shkrim - leximin dhe nivelit të arsimit të këtyre fëmijëve theksojnë se nuk ka rezultate të kënaqshme. Në numrin më të madh të shkollave,

përkatësisht në më shumë se 90% të shkollave, me përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në arsimin e rregullt paraqiten probleme dhe pengesa.

A JEP REZULTATE TË MIRA PËRFSHIRJA E FËMIJËVE ME NEVOJA TË VEÇANTA NË ARSIMIN E RREGULLT?	
Rezultate të mira	63
Fëmijët me nevoja të veçanta e pengojnë ecurinë normale të mësimit me çka pengohen edhe fëmijët e tjerë	43
Rezultate të pakënaqshme	24
Rezultate të shkëlqyeshme	10
Gjithsej	140

6. A ËSHTË SA DUHET I AFTËSUAR KUADRI PROFESIONAL, I CILI PUNON ME FËMIJËT, NË MËNYRË QË MË ME LEHTËSI BALLAFAQOHET ME PROBLEMET?

A ËSHTË SA DUHET I AFTËSUAR KUADRI PROFESIONAL, I CILI PUNON ME FËMIJËT, NË MËNYRË QË MË ME LEHTËSI BALLAFAQOHET ME PROBLEMET?	
Kuadri jo sa duhet është i aftësuar dhe ekzistojnë vështirësi	65
Fare nuk ka kuadër përkatës për punë me këtë kategori të fëmijëve	34
Kuadri fare nuk është i aftësuar dhe me vështirësi ballafaqohet me problemet	26
Po, mjaft është i aftësuar dhe nuk ka kurrfarë vështirësish	15
Gjithsej	140

7. A KA NEVOJË PËR KUADËR TË AFTËSUAR TË VEÇANTË?

A KA NEVOJË PËR KUADËR TË AFTËSUAR TË VEÇANTË?	
	shkolla
Po	129
Jo	11

8. LLOJI I KUADRIT TË AFTËSUAR NË MËNYRË PËRKATËSE, I CILI DO TË PUNONTE ME FËMIJËT ME NEVOJA TË VEÇANTA

Problem i veçantë, i cili gjithashtu e vështirëson arsimin e rregullt të fëmijëve me nevoja të veçanta është kuadri profesional, i cili punon me këta fëmijë, përkatësisht mos angazhimi i kuadrit profesional dhe mungesa e ekipit profesional, i cili do të punonte me këta fëmijë. Në numrin më të madh të shkollave, mësimin me fëmijët me nevoja të veçanta e zhvillojnë arsimtarët e rregullt, të cilët nuk janë të arsimuar e as të aftësuar për punë me fëmijë me nevoja të veçanta. Sipas përgjigjeve të shkollave, vetëm rreth 10% e shkollave kanë kuadër të aftësuar, ndërsa 90% e shkollave konsiderojnë se arsimtarët të cilët e zhvillojnë mësimin e rregullt, duhet të edukohen dhe aftësohen për punë me fëmijë me nevoja të veçanta dhe se në çdo shkollë domosdo duhet angazhuar ekip profesional i përbërë nga defektologu, pedagogu logopedi, psikologu dhe punonjësi social, i cili do të punonte me këtë kategori të fëmijëve.

Njëkohësisht, shkollat teknikisht dhe materialisht nuk janë të pajisura, fëmijët me nevoja të veçanta mësojnë mbi bazë të përmbajtjeve mësimore joadekuate dhe të papërshtatshme, të cilat nuk janë në gjendje t'i përvetësojnë, ndërkohë që për këtë kategori të fëmijëve nuk ka libra të veçantë shkollorë, me çka do të lehtësohej arsimimi i këtyre fëmijëve.

LLOJI I KUADRIT TË AFTËSUAR NË MËNYRË PËRKATËSE, I CILI DO TË PUNONTE ME FËMIJËT ME NEVOJA TË VEÇANTA	
Kuadri i rregullt arsimor, me trajnime shtesë për punë me fëmijët me nevoja të veçanta	70
Ekip profesional i përbërë nga defektologë, pedagogë, logoped, psikologë, punonjës social	66
Nuk janë dhënë përgjigje precize	4

Meqë këta fëmijë përfshihen në paralele të mëdha, nuk ekziston mundësia për punë individuale me ta, ndërkohë që përdoren metoda joadekuate dhe të papërshtatshme të punës duke bërë edhe vlerësim jo përkatës dhe të pa harmonizuar

për përvetësimin e mësimit. Për shkak të këtyre problemeve dhe mangësive, fëmijët vështirë përshtaten në shkolla, bëhen agresivë, me çka fëmijëve të tjerë u pengohet ndjekja normale e mësimit dhe përvetësimit të materialit, ndërkaq arsimtarët nuk kanë mundësi t'u përkushtohen fëmijëve të talentuar.

Vijimi normal i arsimit të fëmijëve me nevoja të veçanta vështirësohet edhe për shkak të faktorëve subjektiv, e këto janë paragjykimet dhe rezistenca e prindërve të fëmijëve të tjerë, mospërkrahja nga fëmijët e tjerë, por edhe për shkak të paragjykimeve dhe mospërkrahjes nga ana e arsimtarëve. Shpesh herë vështirësitë ose pamundësia e arsimimit të fëmijëve me nevoja të veçanta i referohet edhe mungesës së bashkëpunimit të mirë dhe adekuat me prindërit e tyre, të cilët shumë shpesh nuk e pranojnë realitetin, ndërsa në raste të caktuara pengesë për bashkëpunim të mirë është edhe niveli i ulët i arsimimit të prindërve.

Duke i pasur parasysh problemet e shpalosura më lartë, të cilat kanë të bëjnë me përmirësimin e gjendjes dhe tejkalimin e problemeve me arsimimin e fëmijëve me nevoja të veçanta, gjithsesi se para së gjithash nevojitet angazhim i ekipit profesional, i aftësuar dhe i mbathur për punë me fëmijët me nevoja të veçanta, si dhe aftësimi shtesë dhe përsosja profesionale e kuadrit ekzistues. Me qëllim që materiali të përvetësohet sa më me lehtësi, domosdo duhet të zvogëlohet numri i nxënësve në paralelet, në të cilat janë të përfshirë edhe fëmijët me nevoja të veçanta, me qëllim që të krijohen mundësi për punë individuale me këta fëmijë. Gjithashtu, nevojitet edhe gjetja e metodave të reja bashkëkohore dhe përkatëse për arsimimin e fëmijëve me nevoja të veçante dhe përshtatjen e planeve dhe programeve mësimore, si dhe hartimin e librave të veçantë shkollorë. Gjithsesi për t'u mundësuar kushte normale, kësaj kategorie të fëmijëve, nevojitet edhe bashkëpunim i rregullt dhe i mirë me prindërit e tyre, të cilët gjithashtu do të duhej të edukoheshin dhe aftësoheshin për punë me fëmijët.

Problem i veçantë, i cili gjithashtu sjell deri te diskriminimi i fëmijëve me nevoja të veçanta dhe i cili shkakton pengesë në arsim, është edhe mospasja e zgjidhjeve urbane, të cilat do të siguronin qasje normale deri te institucionet arsimore dhe institucionet e tjera. Sipas të dhënave të pranuar, në numrin më të madh të shkollave fillore ose nuk ka kurrfarë zgjidhje urbanistike ose ka një farë lloji, por që nuk janë adekuate dhe nuk mundësojnë qasje të lehtë të fëmijëve me nevoja të veçanta, dhe për sa u përket barrierave të këtylla nevojitet ndërmarrja e masave, për të cilat ekziston edhe obligim ligjor. (Nga gjithsej 140 shkolla të anketuara, në të cilat janë të përfshirë fëmijë me nevoja të veçanta, vetëm në 42 ka ndonjë farë lloji të zgjidhjeve urbanistike, por që nuk janë adekuate, ndërkaq në 75 shkolla nuk ka kurrfarë zgjidhje urbanistike).

Së këtejmi, pa dyshim rezulton se në praktikë, fëmijët me nevoja të veçanta nuk kanë kurrfarë kushte dhe mundësi për vijimin e arsimit fillor, me çka në një farë mënyre janë të diskriminuar.

Prandaj, domosdo duhet të ndërhyjmë dhe të bëjmë presion pranë organeve kompetente për zvogëlimin e problemeve të lartpërmendura dhe krijimin e mundësive dhe kushteve të barabarta për përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në arsimin e rregullt me aplikimin përkatës të procesit arsimor të adaptuar, modernizimin organizativ, teknik dhe kadrovik të shkollave fillore, hartimin e programeve të veçanta dhe botimin e librave të veçantë shkollorë, varësisht nga lloji dhe shkalla e pengesave dhe përshtatjen e zgjidhjeve urbanistike dhe të komunikacionit.

Në kontekst të kësaj paraqesim

PROPOZIME

- të punësohen ose të angazhohen, sipas nevojës, persona profesionistë, përkatësisht në ç'do shkollë ku ka të përfshirë fëmijë me nevoja të veçanta, të formohet ekip profesional i aftësuar për punë me fëmijë me nevoja të veçanta, i përbërë nga defektologu, pedagogu, logopedi, psikologu, nëpunësi social;
- të zbatohet trajnimi shtesë dhe përsosje profesionale e kuadrit ekzistues;
- të zvogëlohet numri i nxënësve në paralelet, në të cilat ka të përfshirë fëmijë me nevoja të veçanta për shkak të punës individuale me ta;
- të sigurohen mjete materiale teknike, përkatësisht mjete përkatëse mbikëqyrëse për punë me këtë kategori të fëmijëve;
- të gjenden metoda të reja mësimore, të cilat do të jenë bashkëkohore dhe përkatëse për arsimimin e fëmijëve me nevoja të veçanta;
- të përshtaten ose të hartohen plane dhe programe të veçanta mësimore për fëmijët me nevoja të veçanta;
- të hartohen libra të veçantë shkollorë për fëmijët me nevoja të veçanta;
- të bëhen ndryshime dhe plotësime të përmbajtjeve mësimore të fakulteteve, me qëllim të arsimimit profesional të arsimtarëve për punë me fëmijët me nevoja të veçanta;
- të vendoset bashkëpunim i rregullt dhe i mirë me prindërit e fëmijëve me nevoja të veçanta dhe prindërit të edukohen për punë me këtë kategori të fëmijëve;
- me kohë të zbulohen, evidentohen dhe t'u ndihmohet fëmijëve me nevoja të veçanta;
- të hapen më tepër qendra ditore, ku do të përkujdesen fëmijët me nevoja të veçanta, me qëllim të përkrahjes sociale dhe ndihmës për fitimin e shprehive elementare.

AVOKATI I POPULLIT
Ixhet Memeti